



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prilato Received/Delivery	22. 08	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstva Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSHHC	5774/2023		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1014/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-Anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtsit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1014/2023 të datës 19.07.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] kundër organit të punësimit Komuna e Obiliqit, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 22.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1014/2023 të datës 19.07.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted]

Arsyetim

Ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën "Nëpunës operatore në data bazë" në Drejtorinë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2013, me datë 19.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 5305/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore lidhur me mos pajtimin për kategorizimin në klasën profesionale 3, me të cilin është klasifikuar pas hyrjes në fuqi Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku e cila në listën e pagave të muajit Qershor 2023 figuron në klasën profesional 3, e njëjta pretendon se duhet të kategorizohet në klasën profesionale 2.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.07.2023 ka dërguar kërkesën për

përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit, ndërsa Këshilli më datë 27.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Obiliqit, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 5305/2023 të datës 19.07.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga Z.D. për ankesa.kpmshk@rks-gov.net i datës 19.07.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 27.07.2023; Akt Emërim i [redacted] i datës 01.01.2013; Letënjoftim i ankueses; Përshkrimin i detyrave të punës i datës 01.02.2011; Ankesë e ankueses me numër protokoli 12806/2023 i datës 16.05.2023; Përgjigje në ankesë me numër Nr.XII-74 i datës 24.05.2023; E-mail nga A.M. për F.K. etj .i datës 13.07.2023; E-mail nga A.M. për Z.D. i datës 19.07.2023; E-mail nga B.B. për A.M. i datës 07.07.2023; E-mail nga A.F. për B.B. i datës 06.07.2023; Kërkesë për korigjimin e gabimeve të ekuivalentimit i datës 10.03.2023; Lista e pagave për muajin Janar – Qershor 2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që të përfundoi procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1014/2023 i datës 19.07.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] **sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja [redacted] sipas Akt Emërimit të datës 01.01.2013 është e punësuar në pozitën *“Nëpunës operatore në data bazë”* në Drejtorinë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim.

Ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka parashtruar ankesë me pretendimin ankimor lidhur me mos pajtimin për kategorizimin në klasën profesionale 3, me të cilin është klasifikuar pas hyrjes në fuqi Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ku e cila në listën e pagave të muajit Qershor 2023 figuron në klasën profesional 3, e njëjta pretendon se duhet të kategorizohet në klasën profesionale 2.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ankesës së ankueses, ka konstatuar se lidhur me pretendimet ankimore të ankueses në këtë procedurë, për të njëjtën çështje Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur sipas vendimit me numër A.nr.794/2023 me numër protokoli 4855/2023 të datës 21.06.2023.

Bazuar në këtë Kolegji konstaton se meqenëse Këshilli brenda periudhës dy vjeçare ka vendosur për ankesën e ankueses sipas vendimit me numër A.nr.794/2023 me numër protokoli 4855/2023 të datës 21.06.2023, atëherë ankesa e ankueses rrjedhimisht është e konsumuar pasi që Këshilli ka vendos sipas Vendimit të lartë cekur, atëherë Kolegji konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës së ankuesit komform dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nen paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimin të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike”.*

Kolegji konstatoi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.1014/2023 të datës 19.07.2023 të parashtruar nga ankuesja [REDACTED]

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1014/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses [REDACTED]
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

